

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: “Sistemim asfaltim i rruges Rinia”

Kjo Kontratë është lidhur më datë 27.09.2016, midis Bashkise Elbasan tani e tutje të referuar si “**Autoriteti Kontraktor**” dhe operatorit ekonomik: “**Victoria Invest**” sh.p.k., të përfaqësuar nga administratori **z.Fatmir Kuçi** i percaktuar me poshte si “**Kontraktuesi**”.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar prokurimit nr. _____

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë **15.08.2016** bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitura përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **133.249.209,72** (njëqind e tridhjet e tremilion e dyqind e dyzet e nentemije e dyqind e nente presje shtatedhjet e dy) lekë (me tvsh), për realizimin e Punëve:

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **13.324.920** (trembedhjetemilion e treqind e njetzet e katermije e nenteqind e njetzet) leke, dhe ne formën e Depozites Bankare/ Certifikates se Garancise, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 27.09.2016 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

PER AUTORITETIN KONTRAKTOR
BASHKIA ELBASAN
KRYETARI

QAZIM SEJDINI
Me Urdhër dhe Porosi
Zv/ KRYETARI
ERVIN SARAÇI

PER KONTRAKTUESIN
“VICTORIA INVEST” sh.p.k.
ADMINISTRATORI

FATMIR KUÇI



Kopje e njëjtit me origjinal
Dr. A. Mubarekaj
Sek. Përgj.
A. Bylyk bashi